

YLLKA PULASHI



Audituese e Lartë në KLSH, Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Lindur në vitin 1977. Diplomuar në Inxhinieri Mekanike(2000). Vjetërsia në punë 12 vite, të gjitha në KLSH. Audituese e Lartë nga muaji shtator 2013.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i investimeve dhe projekteve me financime të huaja.

KLSH: GARANTE E PARASË PUBLIKEⁱ

nga Yllka Pulashi

Një prej etërve themelues të SHBA-së dhe një prej mendjeve më me ndikim në mendimin politik të botës perëndimore James Madison shkruante dikur se, në qoftë se njerëzit do të ishin engjëj nuk do të kishim nevojë për shtet dhe për institucione. Ndërtimi i institucioneve që i ngushtojnë hapësirën shpërdorimit, që kontrollojnë zbatimin e rregullave dhe të normave dhe që nxisin përgjegjshmërinë është një prej sfidave kryesore në një demokraci. Shteti është një entitet, të cilit njerëzit i kane deleguar pushtet për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e tyre, për të krijuar mundësi që të gjithë të mund të japin më të mirën e tyre dhe të mund të gjejnë ambientin më të mirë të mundshëm për ta arritur këtë. Për këtë shkak njerëzit paguajnë taksa, të cilat bëjnë të mundur mbajtjen në këmbë të shtetit. Kjo ngrehinë me gjithë njerëzit brenda është një padyshim një përbindësh që mund të abuzojë shumë lehtë. Paraja është mjeti që mund të shpërdorohet më shumë. Si e tillë paraja është një tundim dhe njeriu apo njerëzit, zyrat dhe institucionet që e administrojnë atë mund të bien në këtë kurth tundim. Dobësia njerëzore është pikërisht ajo që ka parasysh Madison. Mes shumë institucioneve që ndihmojnë shtetin të

kryejë detyrat e tij, ato që kontrollojnë ndikimin e këtyre dobësive janë ndër më të rëndësishmet. Përsa i takon financave publike, ligjshmërisë së përdorimit të tyre, ekonomikitetit të përdorimit të parasë, efikasitetit dhe ndershmërisë, në vendin tonë, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një rol të pazëvendësueshëm.

Eshtë e qartë se, sa më efikas të jetë një institucion kontrolli si, aq më të mira janë edhe rezultatet e përdorimit të parasë publike. Në rast të kundërt aq i keq sa do të ishte një institucion auditimi, aq i keq do të ishte edhe efikasiteti i përdorimit të parasë publike. Në vendet më demokratike, do të shohësh se institucionet e auditimit, simotra të KLSH, ose institucione të ngjashme të auditimit të shpenzimeve dhe përdorimit të parasë publike kanë një shkallë performance të lartë dhe janë të vlerësura nga institucionet shtetërore, të besueshme edhe për opinionin publik e mediat. Ky është edhe vizioni i KLSH: garantimi një institucioni kontrolli të pavarur, kompetent dhe objektiv, që i jep ndihmesë reale Kuvendit, ndërkohë edhe i besueshëm për rezultatet e kontroleve e të rekomandimeve, të cilat duhet të vazhdojnë të pranohen për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, si nga organet legislative, ekzekutive, të medias dhe publiku i gjerë.

Ish guvernatori i Indianës dhe ish drejtori i politikave ekonomike në Shtëpinë e Bardhë Mitch Daniels thoshte më shumë se dy vite më parë (ende në detyrë) se ne e mendojmë gabim të marrim edhe një dollar nga njerëzit si taksa pa një qëllim të qartë publik dhe pa qenë të sigurt se ajo do të përdoret drejt dhe me efikasitet. Për këtë ne kemi politike të kujdesshme buxhetore por edhe i kushtojmë vëmendje të veçantë auditimit të ligjshmërisë së përdorimit të parasë publike. Kjo është gjithçka në një demokraci, në një qeverisje të drejtë dhe kjo nuk mund të bëhet pa e çmuar deri në skajin më të fundëm të përgjegjësisë rolin e KLSH-së.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri ka padyshim një detyrë të vështirë për shkak të shkallës së ulët të perceptimit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies tek zyrtarët e të gjitha niveleve, por edhe për shkak të mjeteve në disa raste jo të mjaftueshme apo edhe të mos vlerësimit në masën e duhur. Për këto arsye, misioni i KLSH që ka të bëjë me rritjen e rolit dhe kontributit në drejtim të mirë-administrimit të financave publike, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve cilësore dhe raportimit mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare shtetërore, në të mirë të shtetit dhe publikut në tërësi, është një sfidë për vetë atë (KLSH-në).

Në dy vitet e fundit, në dhjetëra raste KLSH ka kryer një punë të admirueshme, ka dërguar volume të tëra shkeljesh për ndjekje penale, ka bërë propozime të hollësishme për rishikim politikash, për ndryshim vendimmarrjesh etj. Në të gjitha rastet KLSH nuk ka qenë zëri që është dashur të dëgjohet, në shumë raste ka qenë një zë që nuk ka kaluar shkarazi dhe nuk është mundur të zbehet roli i tij. Kontrolli i Lartë Shtetit është një institucion i epërm i kontrollit financiar i përdorimit të financave dhe ka tagër të shohë çdo projekt, çdo blerje apo shitje të kryer nga shteti, të shohë mënyrën se si është përdorur çdo qindarkë që vjen nga njerëzit dhe është në fakt e tyre. Asnjë qeverisje në Shqipëri sado e përkushtuar që të jetë nuk do të mund të ketë suksese n.q.s KLSH nuk do të jetë ai që kërkon kushtetuta, syri që sheh përdorimin e parasë së publikut, ligjshmërinë dhe efikasitetin e këtij përdorimi. Në fund të fundit është edhe çështje drejtësie dhe jo vetëm suksesi: paraja e atyre që e fitojnë me mund dhe ndershmëri dhe që i jepet shtetit për detyrat që atij i ngarkon kushtetuta, nuk mund të përdoret veçse me ndershmëri. KLSH është e pazëvendësueshme në këtë rol.

ⁱ Botuar në Gazetën "Metropol" dt. 21 Shtator, 2013

